# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6184
E hënë, 7 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €

## Rritet numri i të vdekurve nga Covidi në Kosovë
FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SAFET GËRXHALIU FAQE 4-5

# EKONOMIA NË KOHËN E PANDEMISË ËSHTË POLITIZUAR NË KOSOVË



Njohësi i zhvillimeve ekonomike në vend, Safet Gërxhaliu, i cili është edhe sekretar i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste, ka thënë se ekonomia në kohën e pandemisë është politizuar në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se është pritur dhjetë muaj për të harmonizuar një ligj për rimëkëmbje ekonomike. Gërxhaliu ka theksuar se në kuadër të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike ka shkelje të të drejtave të njeriut ku, sipas tij, ka një qasje shumë më tepër ndarëse ose selektive sesa që do të duhej të ishte. Ai thotë se Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike është një goditje për sektorin privat. "Miratimi i këtij ligji në Kuvend është një hap pozitiv, por nuk duhet pritur shumë. Sapo të fillojë ndarja e mjeteve do të kemi më tepër një efekt psikologjik sesa ekonomik", ka deklaruar Gërxhaliu

## STUDIMI I PREZANTUAR NË PARLAMENTIN EVROPIAN KRITIKOHET NË KOSOVË
FAQE 3



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i kanë hedhur poshtë pretendimet e studimit mbi rolin e lajmeve të rreme në Ballkanin Perëndimor që është prezantuar në Parlamentin Evropian i cili thotë se qeveria e Albin Kurtit ishte rrëzuar "nga një operacion dezinformues amerikan". Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka deklaruar se ky studim është pamflet me plot paragjykime dhe gënjeshtra. Kurse PDK-ja ka vlerësuar se raporti është i rrejshëm dhe ka për qëllim sulmin ndaj ShBA-së. I pabazë raporti është cilësuar edhe nga shoqëria civile

## KUSARI-LILA: VENDI DUHET TË SHKOJË NË ZGJEDHJE TË REJA

## OPINION

### NGA BARAZIMI I KRIMEVE PO SHKOHET NË BARAZIMIN E VIKTIMAVE!
F. 11



Nga Mehmet PRISHTINA

## AKTUALE




### QYTETARËT ANKOHEN PËR TRAJTIM TË PABARABARTË, AVOKATI I POPULLIT PRET FLUKS TË ANKESAVE PAS PANDEMISË
F. 8

### VRITET NJË PERSON NË PRISHTINË
F. 8

## EKONOMI

### OSMANI DEKRETON LIGJIN PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE
F. 8

### SI PËRFUNDOI KOSOVA NË ARBITRAZH NDËRKOMBËTAR NGA "CONTOURGLOBAL"?
F. 8-9



## SPORT

### DRITA E ZBRET BALLKANIN NGA FRONI
F. 12

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Trumpi bën sërish pretendime të pabazuara për zgjedhjet presidenciale

Uashington, 6 dhjetor - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, sërish ka bërë pretendime të pabazuara lidhur me zgjedhjet presidenciale të nëntorit gjatë një tubimi në Xhorxhia. Trump, që ende nuk ka pranuar humbjen, ka ngritur dyshime mbi integritetin e zgjedhjeve të 3 nëntorit dhe më 5 dhjetor, gjatë një tubimi në Xhorxhia, përsëriti pretendimet false për zgjedhjet, ku ka fituar kundërkandidati demokrat Joe Biden. Trump u tha mijëra njerëzve të mbledhur në Valdosta, Xhoxhia, se zgjedhjet ishin të "manipuluara".
Presidenti Trump vazhdon të bëjë pretendime të pabazuara lidhur me mashtrime në zgjedhje, pavarësisht se gjykatat dhe zyrtarët zgjedhorë në shtetet kyçe në mbarë vendin kanë hedhur poshtë këto pretendime. Nga pothuajse 50 padi që janë sjellë në gjykata nga fushata e Trumpit dhe aleatëve të tij, 30 prej tyre janë hedhur poshtë, kryesisht për mungesë të provave, ka raportuar "Associated Press". Ndërsa dhjetëra të tjera janë ende në procedurë. Gjatë këtij tubimi Trump tha se ai do të dërgojë "së shpejti" në Gjykatën Supreme lëndën për këto pretendime, por nuk elaboroi më shumë. Ekspertët ligjorë thonë se ka pak gjasa që këto pretendime të merren parasysh nga gjykatat. Njëra prej kërkesave të ekipit të Trumpit është që t'i shpallë të pavlefshme rezultatet në Xhorxhia. Në këtë shtet tashmë është bërë rinumërimi i votave dhe nuk janë gjetur parregullsi të mëdha. Rinumërimi e ka konfirmuar Bidenin fitues në këtë shtet me 12 670 vota më shumë se Trumpi. Xhorxhia ka certifikuar rezultatin zgjedhor. Bideni ka fituar zgjedhjet me 306 vota elektorale, ndërkaq Trumpi ka 232 vota elektorale.



Kolegji Zgjedhor do të mblidhet më 14 dhjetor për ta formalizuar rezultatin zgjedhor. Transferimi i pushtetit ka nisur dhe Bideni pritet të inaugurohet më 20 janar.

# Britania dhe BE-ja do t'i vazhdojnë bisedimet për Brexitin



Londër, 6 dhjetor - Britania dhe Bashkimi Evropian do t'i rinisin bisedimet më 6 dhjetor në Bruksel, me qëllim që të tejkalojnë një ngërç para se të përfundojë periudha e tranzicionit të Brexitit më 31 dhjetor.
Kryeministri britanik Boris Johnson dhe shefja e BE-së, Ursula von der Leyen, janë pajtuar që të zhvillojnë bisedime, duke thënë se negociatorët do të bëjnë përpjekje për ta finalizuar marrëveshjen. Ekipet e negociatorëve të BE-së dhe Britanisë nuk arritën pajtim më 4 dhjetor. Të dyja palët vazhdojnë të kenë "dallime të theksuara" në disa çështje kyçe, që kanë zvarritur procesin, thuhet në deklaratën e përbashkët të lëshuar nga Johnson dhe von der Leyen. "Teksa pranojmë seriozitetin e këtyre dallimeve, ne ramë dakord që ekipet tona negociatore duhet të bëjnë edhe një përpjekje", shtuan ata.
"Prandaj, ne do t'i instruktojmë shefat e ekipeve tona negociatore që të takohen në Bruksel. Ne sërish do të bisedojmë të hënën në mbrëmje", thuhet në deklaratë.
Britania është larguar nga BE-ja më 31 janar, por shteti ka vazhduar që të tregtojë me bllokun në kushtet e njëjta si më parë. Dështimi për të arritur një marrëveshje deri më 31 dhjetor mund të rezultojë në një divorc "pa marrëveshje" e cila mund të krijonte kaos në kufijtë e Britanisë dhe në sektorin e tregtisë për shkak të tarifave dhe masave të tjera.

# Merkeli: Ndihma e shtetit ndaj bizneseve nuk mund të zgjasë përgjithmonë

Berlin, 6 dhjetor - Kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se ndihma aktuale që shteti po jep ndaj bizneseve që janë prekur nga pandemia e koronavirusit nuk mund të zgjasë përgjithmonë. Këto komente ajo i bëri teksa Parlamenti gjerman po bëhet gati që ta miratojë buxhetin për vitin 2021. "Qeveria federale, shtetet dhe këshillat duhet të punojnë së bashku në mënyrë konstruktive që ta tejkalojmë pandeminë dhe pasojat e saj në mënyrën më të mirë të mundshme", ka pohuar Merkel.
Të martën Bundestagu gjerman pritet të debatojë për buxhetin e vitit të ardhshëm, ku një e treta e buxhetit pritet të jetë e dedikuar për financimin e borxheve, raporton "Dpa". Qeveria gjermane planifikon që të marrë hua edhe 180 miliardë euro vitin e ardhshëm. "Kostot do të jenë edhe më të larta financiare dhe shoqërore nëse shumë biznese kolapsojnë dhe humbën miliona vende pune", ka thënë kancelarja Merkel. Ajo ka shtuar se më 2021 shteti mund të shpenzojë shuma të mëdha parash të cilat i ka kursyer vitet e fundit.
Në përgjithësi, shteti planifikon që të shpenzojë pothuajse gjysmë trilioni euro dhe të marrë hua. Po ashtu janë paralajmëruar edhe shkurtime të taksave për qytetarët.
Merkeli, po ashtu, ka thënë se shpreson që virusi gradualisht do të zhduket pasi të nisë vaksinimi në masë. Megjithatë, ajo ka paralajmëruar se pandemia mund të mos mbarojë brenda muajsh. "Pas pothuajse nëntë muajsh me pandemi, ne tani po



e shohim dritën në fund të tunelit", ka deklaruar kancelarja gjermane, duke shtuar se shpreson se më shumë vaksina do të jenë të qasshme sa më shpejt që të jetë e mundur.



## Sonda kineze mbledh mostra në sipërfaqen e Hënës

Pekin, 6 dhjetor - Sonda kineze që ka marrë mostra nga sipërfaqja e Hënës është ankoruar me sukses në anijen kozmike që po bën rrotullime rreth Hënës.
Kapsula që barte gurë hënorë i është bashkuar anijes kozmike më 6 dhjetor, ka njoftuar agjencia e lajmeve "Xinhua", duke cituar Administratën Kombëtare të Kinës për Hapësirë. Sonda që zbarkoi në Hënë më 3 dhjetor, u bë sonda e parë në katër dekada, që një sondë e ndonjë shteti mbledh mostra hënore, pas misioneve të Shteteve të Bashkuara dhe sovjetikëve në vitet '60 dhe '70.
Edhe një kapsulë me rreth 2 kilogramë gurë dhe pluhur hënorë pritet të zbarkojë në Kinë në mesin e dhjetorit. Kina kishte kryer misione në Hënë edhe më 2013 dhe 2019. Programi hapësinor kinez shpreson që më 2022 ta ketë ekipin në një stacion hapësinor dhe eventualisht të dërgojë njerëz në Hënë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Reagime të shumta e kanë përcjellë publikimin e studimit mbi rolin e lajmeve të rreme në Ballkanin Perëndimor që është paraqitur në Parlamentin Evropian (PE)

# Studimi i prezantuar në Parlamentin Evropian kritikohet në Kosovë

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i kanë hedhur poshtë pretendimet e studimit mbi rolin e lajmeve të rreme në Ballkanin Perëndimor që është prezantuar në Parlamentin Evropian i cili thotë se qeveria e Albin Kurtit ishte rrëzuar "nga një operacion dezinformues amerikan". Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka deklaruar se ky studim është pamflet me plot paragjykime e gënjeshtra. Kurse PDK-ja ka vlerësuar se raporti është i rrejshëm dhe ka për qëllim sulmin ndaj ShBA-së. I pabazë raporti është cilësuar edhe nga shoqëria civile

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Studimi mbi rolin e lajmeve të rreme në Ballkanin Perëndimor, i prezantuar në Parlamentin Evropian (PE), ka nxitur reagime të shumta në vend. Studimi i cili thotë se dezinformimi në Kosovë ka shkaktuar rënien e qeverisë së Albin Kurtit është kritikuar ashpër nga LDK-ja dhe PDK-ja. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka deklaruar se ky studim është pamflet me plot paragjykime e gënjeshtra. Sipas tij, i porositur nga Komiteti për Politikë të Jashtme i Parlamentit Evropian, flet edhe për kompleksin e inferioritetit të tyre kundrejt ShBA-së. "Ajo që i mungon këtij pamfleti është që t'iu prezantohet parlamentarëve evropianë rrena se: LDK-ja dhe kryetari i saj Isa Mustafa janë eksponentë të dhunës, ndërkaq LV-ja parti paqësore e demokratike me orientime evropiane dhe euroatlantike; se LDK-ja dhe kryetari i saj kanë kundërshtuar ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi dhe dialogun e përkrahur nga BE-ja dhe ShBA-të dhe si pasojë mbeti Kosova pa liberalizim të vizave, kurse pëllumbat e LV-së kishin bashkëpunim konstruktiv me BE-në dhe ShBA-në; se LDK-ja ka organizuar protesta të dhunshme, ka gjuajtur me molotov ndërtesat qeveritare, bile edhe Kuvendin me granatë, ndërkaq LV-ja ka kundërshtuar veprimet e tilla", ka shkruar Mustafa në profilin e vet në "Facebook".

Sipas tij, ky material ka logjikë fashiste dhe frymë ruse. "Dhe fare nuk çuditem që edhe këso dezinformata studimore të lexojë. Hitleri i ka vrarë ushtarët e vet për t'ia veshë fajin dhe për të krijuar shkas për okupim të Polonisë. Millosheviqi ka vrarë të rinj serbë për t'ua veshë shqiptarëve dhe për ta filluar gjenocidin në Kosovë. Logjika fashiste është e tmerrshme. Gënjeshtrat kombëtare dhe ndërkombëtare nuk kanë fund. Nuk marrin fund as përpjekjet denigruese dhe poshtëruese të Vetëvendosjes dhe shokëve të tyre me përvoja të gjata dhe dashuri ruse. Të gjitha këto të financuara me para të taksapaguesve evropianë", ka shkruar ai.

Lidhur me këtë raport ka reaguar edhe zëdhënësi i PDK-së, Avni Bytyçi, duke thënë se ky raport është i rrejshëm dhe ka për qëllim sulmin ndaj ShBA-së. "Një gjë është e sigurt, ky raport i rrejshëm për PE që flet për dezinformim nuk e ka qëllim Kosovën, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rusia dhe Kina në vazhdimësi kanë ndërhyrë në vende të ndryshme të botës përmes dezinformimit dhe lajmeve të rrejshme, duke përfshirë këtu edhe zgjedhjet në Amerikë", ka shkruar ai në "Facebook". Sipas tij, LV-ja në këtë raport ka qenë vetëm mjet për arritjen e një qëllimi më të madh. "Qëllimi i këtij raporti ka qenë padyshim që përmes një rezolute me dënu rrëzimin e qeverisë Kurti nga zyrtarët amerikanë përmes dezinformimit. Pra, Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje këtu kanë qenë vetëm mjete për një qëllim më të madh. Për fat të keq, siç po duket nga përmbajtja, ata që janë prapa këtij raporti kanë gjetur edhe aleatë në Kosovë", ka shkruar ai.

Në këtë studim thuhet se mesazhet në rrjetet sociale që vinin nga Isa Mustafa dhe Kadri Veseli, ish-kryetar i PDK-së, posaçërisht kanë nxitur mashtrimin e aferës Grenell, i cili është i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për bisedimet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Raporti flet edhe për disa medie në vend, ku pretendon se kanë shpërndarë lajme të rrejshme. Kjo ka nxitur reagimin e këtyre mediave, duke demantuar raportin.

Ekspertja e medieve, Flutura Kusari, përmes një shkrimi në "Facebook" e ka cilësuar raportin si të dobët dhe me pretime të pabazuara. "Raport përgjithësisht i dobët, me pretendime të pabazuara dhe të paargumentuara (sidomos pjesa për Kosovën). Në vend të histerisë publike, palët e përmendura dhe institucionet tona duhet t'i drejtohen zyrtarisht David McAllister, komiteti i të cilit e ka porositur raportin", ka shkruar ajo. Sipas saj, pjesa e raportit që flet për Shqipërinë është shkruar edhe më keq. "Në këtë raportin e porositur nga komitetit AFET, kurrgjë nuk qenka e dobët pjesa për Kosovën, çka qenka e shkruar keq dhe e paargumentuar pjesa për Shqipërinë. Qysh themi na, autorët paskan bo llaf e muhabet", ka thënë Kusari.

Studim mbi rolin e lajmeve të rreme në Ballkanin Perëndimor, i prezantuar në Parlamentin Evropian (PE), thotë se fenomeni i dezinformimit në Kosovë ka pasur implikime të drejtpërdrejta politike që shkaktuan edhe rënien e qeverisë së Albin Kurtit. "Vetë koalicioni ishte jetëshkurtër dhe u rrëzua nga një operacioni dezinformues amerikan", thuhet në studimin i cili u bë nga disa autorë evropianë, të porositur për nevojat e Komitetit të Politikës së Jashtme të PE (AFET).

Ky studim tregon për trendët dhe modelet kryesore të dezinformatave dhe luftën kundër dezinformatave në gjithë rajonin në periudhën nga viti 2018 deri më 2020.

Dokumenti shpjegon angazhimin e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump dhe emërimin e të dërguarit të tij të posaçëm për bisedimet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, Richard Grenell. "I frustruar nga ajo që ai e pa si pengesë nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ambasadori Grenell si duket aranzhoi që senatori David Perude dhe djali i presidentit amerikan, Donald Trump Jr., të bënin një deklaratë në 'Twitter' që sugjeronte se trupat amerikane do të tërhiqeshin nga Kosova. Ambasadori Grenell vazhdoi ta mbante këtë kërcënim i cili nuk ishte bërë nga asnjë zyrtar amerikan në negociatat me partnerët e koalicionit të Kurtit, duke bërë që të ngrihej një mocion mosbesimi që rrëzoi qeverinë Kurti", është thënë në studim.





FLET PËR "EPOKËN E RE", SAFET GËRXHALIU

# EKONOMIA NË KOHËN E PANDEMISË ËSHTË POLITIZUAR NË KOSOVË

Njohësi i zhvillimeve ekonomike në vend, Safet Gërxhaliu, i cili është edhe sekretar i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste, ka thënë se ekonomia në kohën e pandemisë është politizuar në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se është pritur dhjetë muaj për të harmonizuar një ligj për rimëkëmbje ekonomike. Gërxhaliu ka theksuar se në kuadër të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike ka shkelje të të drejtave të njeriut ku, sipas tij, ka një qasje shumë më tepër ndarëse ose selektive sesa që do të duhej të ishte. Ai thotë se Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike është një goditje për sektorin privat. "Miratimi i këtij ligji në Kuvend është një hap pozitiv, por nuk duhet pritur shumë. Sapo të fillojë ndarja e mjeteve do të kemi më tepër një efekt psikologjik sesa ekonomik", ka deklaruar Gërxhaliu

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar të premten që lamë pas Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike me 72 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Miratimi i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike erdhi pas pajtimit të qeverisë Hoti me kërkesat e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) lidhur me këtë projektligj. Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike nuk është përkrahur nga partia opozitare, Lëvizja Vetëvendosje.

Një ndër propozimet e reja në kuadër të projektligjit është themelimi i një granti prej 200 milionë eurosh për ndihmë direkte financiare bizneseve të cilat kanë vështirësi të funksionimit si rezultat i ndikimit të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Këto mjete do t'u shpërndahen të gjitha bizneseve sipas kritereve dhe kushteve të caktuara nga ana e një komisioni të posaçëm, i cili do të themelohet ekskluzivisht për këtë çështje nga Qeveria e Kosovës. Sipas këtij projektligji, të gjithë punëtorët që kanë humbur vendin e punës për shkak të ndikimit të pandemisë do të paguhen nga Qeveria e Kosovës me nga 300 euro për periudhën tetor-dhjetor 2020.

Edhe kontributpaguesit mund t'i tërheqin 10 për qind të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Sipas projektligjit, deri në shumën 10 mijë euro, në rast të tërheqjes së 10-përqindëshit nga kontributpaguesi, Qeveria e Kosovës do ta kompensojë atë brenda pesë vjetëve të ardhshme. Projektligji ka paraparë që lënda e parë e cila prodhohet nga veprimtaritë biznesore në Kosovë, pavarësisht a eksportohet jashtë vendit, të lirohet nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh).

Lidhur me kalimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" ka folur njohësi i zhvillimeve ekonomike në vend, njëherësh sekretar i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste, Safet Gërxhaliu. Ai ka thënë se ekonomia në kohë pandemie është politizuar në Kosovë, duke theksuar se është pritur pothuajse dhjetë muaj për të harmonizuar një ligj për rimëkëmbje ekonomike.

Gërxhaliu ka pohuar se në kuadër të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike ka shkelje të të drejtave të njeriut. Sipas tij, ka një qasje shumë më tepër ndarëse ose selektive sesa që do të duhej të ishte. "Miratimi i këtij



ligji në Kuvend është një hap pozitiv, por nuk duhet pritur shumë. Sapo të fillojë ndarja e mjeteve do të kemi më tepër një efekt psikologjik sesa ekonomik, pasi qytetarët po mendojnë se është duke i mbështetur shteti por, në fakt, shteti vetëm po ua transferon shumën e mjeteve që ata kanë paguar nga të ardhurat e tyre", është shprehur ai.

Gërxhaliu ka theksuar se ky ligj është një goditje për sektorin privat, në veçanti kur kemi parasysh faktin e informalitetit enorm të pranishëm në Kosovë.

**"Epoka e re":** *Z. Gërxhaliu, cilat janë pritjet tuaja pas miratimit të Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike?*

**Gërxhaliu:** Duke pasur parasysh faktin se është pritur pothuajse dhjetë muaj për të harmonizuar një ligj të tillë, edhe pse Kosova ndodhej në kohë pandemie, zvarritja që iu bë këtij projektligji nga deputetët e Kosovës dëshmon më së miri mjerimin se në çfarë gjendje është Kosova. Ky ligj është vonuar jashtëzakonisht shumë. Nëse një ligj i tillë përdoret si shkas për të shantazhuar dhe për t'u pozicionuar diku, atëherë mund të themi se me të vërtetë është një ligj i turpit. Në kuadër të këtij ligji ka edhe shkelje të të drejtave të njeriut. Ka një qasje shumë më tepër ndarëse ose selektive sesa që do të duhej të ishte. Ky ligj është një goditje për sektorin privat, në veçanti kur e kemi parasysh faktin e informalitetit enorm të pranishëm në Kosovë. Prandaj, pritjet nga ky ligj duhet të jenë të matura. Miratimi i këtij ligji në Kuvend është një hap pozitiv, por nuk duhet pritur shumë. Sapo të fillojë ndarja e mjeteve, do të kemi më tepër një efekt psikologjik sesa ekonomik, pasi qytetarët po mendojnë se është duke i mbështetur shteti por, në fakt, shteti vetëm po ua transferon shumën e mjeteve që ata kanë paguar nga të ardhurat e tyre. Këto para do të ndikojnë për rritjen e konsumit, i cili do të reflektojë në rritjen e inflacionit dhe eksportim të parasë së gatshme nga Kosova. Prandaj, Kosova në të vërtetë është në një situatë të mjerueshme kur luftohet për pushtet dhe jo për shtet, ku luftohet për pozicione dhe jo për ndihmë për qytetarët dhe bizneset private. Ajo çfarë është më shqetësuese, derisa vendet e rajonit do të kenë nevojë për rimëkëmbje në dy apo tri vitet e ardhshme, Kosovës do t'i duhet të paktën dyfishi i asaj kohe. Shto këtu faktin se të gjitha shtetet e rajonit kanë bërë më shumë për qytetarët dhe për bizneset. Në Kosovë ekonomia në kohë pandemie është politizuar dhe është ngulfatur ardhmëria e kësaj ekonomie.

**"Epoka e re":** *Çfarë shpenzimesh buxhetore duhet të shkurtohen në mënyrë që të kemi një rimëkëmbje më të shpejtë ekonomike?*

**Gërxhaliu:** Duhet të kuptohet se e tëra çfarë kërkohet është të kemi sundim të rendit dhe ligjit. Duhet të kemi transparencë dhe deorientim nga asfalti dhe nga projektet kapitale, ku kemi shumë më tepër përfitime nga grupe të interesit dhe më së paku bëhet për bizneset dhe qytetarët. Në këtë drejtim duhet vërtet të kemi disiplinë financiare e cila me të vërtetë Kosovës i ka munguar, kur dihet se presionet politike janë aq të mëdha për financa. Kjo çështje do të mbetet sfiduese.

**"Epoka e re":** *Pritet që Kosova të ketë zgjedhje të nivelit lokal në vitin 2021, çfarë ndikimi do të ketë në aksin e rimëkëmbjes ekonomike?*

**Gërxhaliu:** Këto zgjedhje me të vërtetë do të jetë barrë e rëndë për buxhetin e shtetit dhe do të duhej që të ketë presion që të shkurtohen shpenzimet buxhetore në këtë kohë. Kosova është në sfida të shumta dhe nëse dikujt i ka mbetur një grimë moral politik, atëherë duhet të mendohet për bizneset private, ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, si dhe të mendohet më shumë për qytetarët e Kosovës.

**"Epoka e re":** *Kosova s'ka shënuar përparim sa iu përket investimeve të huaja. A duhet të jemi më fleksibilë pas pandemisë në këtë drejtim?*

**Gërxhaliu:** Investimet e huaja në Kosovë nuk duhet të shikohen vetëm nga dimensioni ekonomik, por duhet të analizohen edhe në dimensione të tjera. Përderisa vendet e rajonit janë duke shënuar rekorde, ne kemi ngulfatur biznesin në Kosovë. Kemi raste të shumta kur përfitojnë grante dhe subvencione personat e lidhur me politikën. Prandaj nuk mund të mendojmë për donatorë dhe investime të huaja kur veprohet kështu. Kemi pak storie suksesi në Kosovë. Disa nga investitorët e huaj fillimisht po shikojnë se cila parti politike është në pushtet dhe tek pastaj po qasen në analiza ekonomike.

# Qytetarët ankohen për trajtim të pabarabartë, Avokati i Popullit pret fluks të ankesave pas pandemisë

**Prishtinë, 6 dhjetor** - Avokat i Popullit, Naim Qelaj, ka thënë se që nga marrja e mandatit vështirësitë më të mëdha kanë qenë pas shpërthimit të pandemisë, gjë e cila ka ndikuar në shkurtimin e punës dhe të stafit. Ai thotë se gjatë pandemisë ka pasur rënie të ankesave nga qytetarë për shkak të mosfunksionimit të mirë të institucioneve. Madje ai tha se pret që pas kalimit të kësaj situate do të ketë fluks më të madh të qytetarëve sa iu përket ankesave. Sipas tij, zvarritjet e procedurave gjyqësore janë ato më shqetësuese sepse po vazhdojnë vit pas viti dhe akoma nuk kanë gjetur zgjidhje për t'u ofruar qytetarëve një gjykim të drejtë sa i përket qasjes në dokumente zyrtare. "Padyshim që vështirësitë kryesore kanë qenë në periudhën kur unë e kam pranuar mandatin e avokatit të popullit sepse ishte periudha e kulmit të shpërthimit të pandemisë të cilat kanë ndikuar në reduktimin e punës, stafit. Ankesat në njëfarë mënyrë kanë




pasur rënie në periudhën e pandemisë dhe kjo do një analizë dhe vlerësim. Sigurisht kjo ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit të mirë të institucioneve të pushtetit dhe në këtë formë edhe adresimi i ankesave ka qenë më i paktë, ndërsa natyra e ankesave lidhet me çështjet problematike që janë ballafaquar qytetarët në të kaluarën", ka thënë Qelaj për "Ekonomia Online".

Ai ka shtuar se mosofrimi i qasjes në dokumente zyrtare është një shqetësim jo vetëm për fatin që nuk po ofrohet, por ekzistojnë mjetet ligjore që secili qytetar që kërkon qasje në dokumente mund ta sigurojë atë, por me shumë probleme. "Unë pres që pas kalimit të kësaj situate do të ketë fluks të qytetarëve", ka thënë Qalaj.

# Vritet një person në Prishtinë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Një person është vrarë me armë zjarri në rrugën "Bashkim Fehmiu" në Prishtinë, ka njoftuar të dielën Policia e Kosovës. Siç thuhet në një komunikatë të policisë, pas informacionit që kanë marrë organet e rendit, rreth orës 12:00 të ditës së diel ato kanë dalë në vendin e ngjarjes, ku në një veturë kanë gjetur trupin e pajetë të një personi, ndërkaq personi për të cilin dyshohet se e ka kryer krimin është larguar nga vendi i ngjarjes. "Rreth orës 12:00 policia ka marrë informatën për rastin e ndodhur në rrugën 'Bashkim Fehmiu' në Prishtinë dhe menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes është konstatuar se bëhet fjalë për vrasje dhe ngritur dyshimi se i dyshuari dhe viktima kanë qenë brenda të njëjtës veturë dhe i dyshuari nga mbrapa ka shtënë me armë zjarri në viktimën, mashkull, i cili, për pasojë, ka humbur jetën", ka njoftuar Policia e Kosovës.
Në këtë njoftim theksohet se në vendin e ngjarjes janë ftuar edhe specialistë për hetimin e rasteve të vrasjeve si dhe njësitë e specializuara për ekzaminim të vendngjarjes. "Në bashkëpunim me prokurorin e shtetit ka nisur një hetim me qëllim të sqarimit dhe ndriçimit të rrethanave dhe motiveve që kanë sjellë deri te ky rast tragjik. Deri më tani policia ka arritur të identifikojë të dyshuarin e mundshëm që dyshohet të jetë shtetas i huaj i cili ka ikur nga vendi i ngjarjes. Aktualisht policia ka shtuar veprimet e saj për ta zbuluar vendndodhjen e tij të dyshuarit me qëllim kapjen e tij", ka njoftuar Policia e Kosovës.




# 'Let's Do It' shpall vullnetarët e dalluar të vitit 2020




Prishtinë, 6 dhjetor (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarëve, "Let's Do It" shpalli vullnetarët e dalluar të vitit 2020. Përzgjedhja e këtyre vullnetarëve është bërë në bazë të angazhimit të tyre vullnetar në aktivitete për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe në aktivitete humanitare e të tjera që lidhen me luftën kundër pandemisë Covid-19 të cilat janë zhvilluar që nga fillimi i pandemisë në vendin tonë në kuadër të Grupit "Vullnetarët/Volunteers Covid-19" të iniciuar nga "Let's Do It". Vullnetarët e vitit 2020, të shpallur nga organizata "Let's Do It", si një ndër organizatat më të mëdha në vend që promovon punën vullnetare, janë këta: Miranda Veseli, Ridvan Tahiri, Mihana Goga Bekteshi, Endrit Januzaj, Valbona Mazreku, Agron Murseli, Arjeta Maka, Burim Qarri dhe Albert Mulaj. Me këtë rast, këta vullnetarë pranuan vlerësime dhe falënderime për punën e palodhur të tyre.
Përveç falënderimit për vullnetarët, "Let's Do It Kosova" kërkoi edhe një herë nga institucionet përgjegjëse që puna e vullnetarëve të njihet edhe me ligj, në mënyrë që të krijohet një ambient më i favorshëm për zhvillimin e vullnetarizmit në Kosovë. Në Ligjin për Vullnetarizmin, vullnetarëve duhet t'u lejohet angazhimi në aksione, të njihet kontributi i tyre, si dhe të përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. "U bëj apel institucioneve tona që të jenë më të angazhuara në përkrahje të vullnetarëve. Ky kontribut duhet të njihet dhe vlerësohet prej institucioneve. Të mblidhemi të gjithë së bashku dhe ta gjejmë një mënyrë për t'i motivuar vullnetarët, por edhe të tjerët që t'i bashkëngjiten", u shpreh drejtori ekzekutiv i "Let's Do It", Luan Hasanaj.
Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit është vendosur nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara në vitin 1985. Qëllimi i kësaj dite është të falënderohen vullnetarët për përpjekjet e tyre në komunitet dhe për ta rritur ndërgjegjësimin e publikut për të kontribuar në shoqëri.

# Agim Zuzaku zgjedhet kryetar i Degës së AAK-së në Gjilan

GJILAN, 6 DHJETOR (ER) - Agim Zuzaku është zgjedhur kryetar i Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në Gjilan. "Për shkak të rrethanave me të cilat po ballafaqohemi si shoqëri e si shtet, dhe mbarë njerëzimi si pasojë e pandemisë Covid-19, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Dega në Gjilan, nuk ka mundur të organizojë një proces të brendshëm zgjedhor, andaj mblodhëm Këshillin Drejtues të Degës në Gjilan i cili zgjodhi kryetarin e saj. Këshilli Drejtues i Degës së AAK-së në Gjilan me votë unanime ka zgjedhur kryetar të degës Agim Zuzakun", është bërë me dije në njoftimin e AAK-së në Gjilan.
Agim Zuzaku ka qenë nënkryetar i AAK-së në Gjilan dhe drejtor i Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Gjilanit nga radhët e këtij subjekti politik. "Të gjithë e njohin si ish-drejtor i Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Gjilanit. Zuzaku ka shërbyer si drejtor në periudhën 2015-2018, ndërsa ishte edhe kryetar i Klubit të Volejbollit 'Drita' dhe punëtor sportiv për vite me radhë. Ka lindur më 21 shkurt 1979, është i martuar dhe ka një vajzë. Është ekonomist i diplomuar, tani në procedurat përfundimtare për titullin doktor i shkencave në fushën e menaxhimit. Përveç Gjilanit, Zuzaku njihet edhe më gjerë si asistent shumëvjeçar i profesorit tanimë të ndjerë, dr. Rifat Blaku, në lëndët: Ekonomi e Resurseve, Ekonomia e Kosovës dhe BE-së, dhe Menaxhimi i Resurseve Njerëzore. Aktualisht është këshilltar politik i ministrit të Ekonomisë dhe Ambientit', thuhet në njoftimin e AAK-së.



## Lladrovci pret në shtëpi Ukë Rugovën

Drenas, 6 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në shtëpi djalin e ish-presidentit Ibrahim Rugova, Ukën. Për këtë takim Lladrovci ka njoftuar në llogarinë e vet në "Facebook". "Mysafiri im, Ukë Rugova, ishte i mirëseardhur dhe ishte rast të diskutonim për bashkëpunimin tonë sa ishim deputetë, për aktualitetin, por edhe për ngjarjet e historisë sonë të re. Në Memorialin e Dëshmorëve në Gllanasellë, z. Ukë Rugova vendosi lule të freskëta dhe kemi bërë homazhe, po ashtu vizituam vendin e rënies së heroit e heroinës Fehmi e Xhevë Lladrovci, Fatime Hetemi dhe Shefqet Zeka! Përgjithmonë falënderues për kontribuuesit e lirisë sonë. Krenarë me të kaluarën për të cilën dhamë aq sa patëm mundësi, pa kursyer asgjë. Gjatë vizitës ishte rast t'ia dhuroj librin e Bedri Islamit 'Përjetësia e dyfishtë', kushtuar Fehmi e Xhevë Lladrovcit", ka shkruar Lladrovci.



# Rritet numri i të vdekurve nga Covidi në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të dielën se 19 pacientë që kanë qenë të infektuar me Covid-19 kanë vdekur gjatë 24 orëve të fundit. Gjatë 24 orëve të fundit, pas testimit të 1 314 mostrave, në Kosovë janë regjistruar edhe 468 raste të reja me Covid-19

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 6 DHJETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 314 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve kanë rezultuar 468 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 19 raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komuna: Pejë tri raste (85, 74, 52 vjeç), Prizren tri raste (91, 76, 60 vjeç), Prishtinë dy raste (87, 65 vjeç), Ferizaj dy raste (79, 78 vjeç), Gjakovë dy raste (64, 51 vjeç), Gjilan dy raste (78, 70 vjeç), Drenas dy raste (78, 73 vjeç), Klinë një rast (53 vjeç), Suharekë një rast (73 vjeç), Shtërpc një rast (74 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 42 805 raste nga 152 677 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 106 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 683 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 28 504 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 13 195.

Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 227 raste, Fushë-Kosovë 25 raste, Pejë 22 raste, Lipjan 21 raste, Gjakovë 20 raste, Prizren 18 raste, Drenas 16 raste, Mitrovicë 15 raste, Gjilan 14 raste, Deçan 10 raste, Vushtrri 10 raste, Ferizaj 9 raste, Malishevë 8 raste, Obiliq 8 raste, Istog 7 raste, Kamenicë 6 raste, Rahovec 5 raste, Suharekë 5 raste, Viti 5 raste, Skenderaj 4 raste, Kaçanik 3 raste, Podujevë 3 raste, Shtime 3 raste, Klinë 2 raste, Dragash 1 rast, Hani i Elezit 1 rast.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka theksuar se pakujdesia na dërgon shumë shpejt në mbingarkesën e institucioneve shëndetësore dhe shtimin e rasteve fatale. "Asnjë vend në botë nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe infrastrukturë spitalore ta përballojë shtimin e rasteve për shkak të papërgjegjësisë për moszbatimin e rekomandimeve tashmë të vetme në mbarë botën: maska, distanca, higjiena!", ka njoftuar IKShPK-ja.

Ky institut ka theksuar se, edhe përkundër masave dhe rekomandimeve, vërehet fluks i shtuar i lëvizjes së qytetarëve kudo nëpër Kosovë. "Kjo është sjellje e rrezikshme dhe lehtësimi i lëvizjes nuk nënkupton mosrespektimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Pakujdesia e disa qytetarëve gjatë këtyre lëvizjeve dhe aktiviteteve shton rrezikun e përhapjes së infeksionit përderisa virusi SARS-COV-2 është prezent dhe kështu mund të mbingarkohet sistemi shëndetësor me pasoja të paparashikuara deri në shpërthim e që mund të paraqesë rrezik për jetën e qytetarëve", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike u ka bërë thirrje qytetarëve, institucioneve publike e private, bizneseve, gastronomëve, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura. "Burimet e infeksionit janë të shpërndara në institucione publike, private, agjenci, shkolla dhe amvisëri", theksohet në njoftimin e IKShPK-së.

Ndërkaq ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se qytetarët nuk duhet të shqetësohen për furnizime me oksigjen në institucionet publike shëndetësore në Kosovë. "Të gjitha institucionet tona shëndetësore bëjnë furnizimin e rregullt me oksigjen duke garantuar jetën e pacientëve konform ligjeve dhe etikës profesionale", ka thënë Zemaj në një konferencë për media.

Ministri Zemaj ka thënë se institucionet publike shumë shpejt do të fillojnë të bëjnë edhe teste serologjike për të kuptuar më shumë për statusin imunologjik të popullatës, në raport me koronavirusin. Përmes testeve serologjike një person kupton nëse ka tejkaluar koronavirusin dhe nëse ka krijuar antitrupa. Po ashtu, Zemaj ka bërë me dije se shumë shpejt edhe gjashtë qendra rajonale do të mund të kryejnë teste PCR për koronavirus, të cilat tregojnë nëse një person është i infektuar me këtë virus në kohën e testimit.

## Kusari-Lila: Vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja



PRISHTINË, 6 DHJETOR - Deputetja e Kuvendit të Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se kandidati për president, Ramush Haradinaj, me qasjen e tij të votës "veresi", ka treguar se është i gatshëm ta shkelë Kushtetutën ende pa hyrë në Presidencë. Kusari-Lila ka thënë se presidenti duhet të zgjidhet pas zgjedhjeve të reja. "Një legjislaturë e re mbetet ta zgjedhë presidentin dhe apo presidenten e re. Vetë qasja dhe hyrja e tij në garë për postin e të parit të vendit tregon se ai është i prirë për shkelje kushtetuese ende pa hyrë brenda në zyrë. Mënyrën se si e mendonte tregtimin e votës, t'ia marrë dikujt, për t'ia dhënë më vonë nga zyra e presidentit, tregon se ai është i prirë për shkelje kushtetuese ende pa hyrë në zyrë", ka thënë Kusari-Lila për "Ekonomia Online". Ajo ka thënë se zgjedhjet e jashtëzakonshme janë të nevojshme për shkak të situatës që po kalon vendi. "Jemi në një situatë të tillë kur kemi krizë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit jo vetëm për shkak të pandemisë, por edhe krizat e tjera me probleme të theksuara dhe me krizat e vazhdueshme institucionale që kanë ndodhur me veprimet e Gjykatës Speciale, domosdoshmërisht vendi duhet të shkojë në zgjedhje", ka deklaruar Kusari-Lila.



# Si përfundoi Kosova në arbitrazh ndërkombëtar nga "ContourGlobal"?

**Prishtinë, 6 dhjetor** - Pa termocentral të ri dhe në rrezik të humbjes së 20 milionë eurove, mund të përfundojë marrëveshja komerciale e Qeverisë së Kosovës me kompaninë amerikane "ContourGlobal" për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re".

I vlerësuar si një nga investimet më të mëdha të huaja në Kosovë në vlerë prej 1.3 miliard eurosh, ky projekt nuk u finalizua.

Investitori "ContourGlobal", përveç që u tërhoq nga ndërtimi i termocentralit në mars të këtij viti, e dërgoi Kosovën edhe në Gjykatën e Arbitrazhit Ndërkombëtar për mosrespektim të kontratës.

Më 24 maj 2020, sipas Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ka qenë e paraparë që të bëhet mbyllja financiare e projektit Termocentrali "Kosova e Re", por kjo nuk është arritur në kohë.

Në rast të mospërfundimit të këtyre procedurave, me kontratë ishin paraparë ndëshkime financiare për palën e cila nuk i përmbush obligimet.

Nëse zvarritjet e kontratës me "ContourGlobal" shkaktoheshin nga Kosova duke mos i përmbushur obligimet, atëherë Qeveria e Kosovës do të ketë si përgjegjësi financiare ndaj kompanisë "ContourGlobal" një vlerë prej 19.7 milionë eurosh.

Ndërsa, nëse Kosova i përfundon obligimet, por "ContourGlobal" nuk arrin ta sigurojë pakon financiare, atëherë kjo kompani do t'i detyrohet Kosovës një vlerë prej 17.5 milionë eurosh.

### Tërheqja e "ContourGlobal"

Në atë kohë në pushtet ishte koalicioni qeverisës Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje ishte shprehur kundër marrëveshjes me "ContourGlobal" dhe, sipas LV-së, ky projekt, si i tillë, nuk do të realizohet pasi kompania në fjalë mund ta rrisë çmimin e faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike. Ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës ishte shprehur se do të ndërtojë kapacitete të reja energjetike, por do ta refuzojë secilën alternativë investuese që shtrenjton çmimin përfundimtar të energjisë elektrike prej 100-përqindësh.

### Hajdari: Morëm të gjitha masat e nevojshme

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar ish-ministren e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike në Kosovë, Rozeta Hajdari, për të parë se çfarë ka ndodhur në kohën kur kompania ishte tërhequr nga projekti. Ajo në një përgjigje me shkrim thotë se ContourGlobal ka njoftuar se po tërhiqet nga projekti disa ditë pasi qeveria kishte marrë vendim për themelimin e komitetit drejtues të projektit. "Ne kemi analizuar kontratat dhe gjendjen e projektit. Kemi diskutuar çështjen në komitetin drejtues dhe me pajtimin e komitetit, kemi ftuar 'ContourGlobal'-in në takim në lidhje me projektin. Me propozimin tonë, komiteti ka marrë vendim në emër të qeverisë për të angazhuar një ekip të avokatëve të dalluar, që do ta këshillonin Republikën e Kosovës lidhur me projektin. Qeveria e tanishme nuk e ka zbatuar vendimin tonë", thotë Hajdari.

Ajo thotë se projekti në kohën kur ajo ka qenë ministre, ka qenë në fazën e përmbushjes së kushteve paravajtëse dhe se mbyllja financiare ka qenë e paraparë për 24 maj 2020.

Këtë afat, shton ajo, Kosova nuk e ka shkelur, por "ContourGlobal" ka dështuar t'i përmbushë detyrimet e veta. "Më 3 qershor 2020 ne i kemi dërguar letër 'ContourGlobal'-it. Në këtë letër kemi refuzuar kërkesën e pabazë për pagesë paushalle në lartësi mbi 20 milionë euro, kemi shpjeguar pse kontratat me 'ContourGlobal'-in kanë qenë juridikisht të pavlefshme", thotë ajo.

Në këtë letër, po ashtu, Hajdari bën të ditur se e kishin paralajmëruar "ContourGlobal"-in se Kosova mund t'i kërkojë kompensim të dëmit.

Gjithashtu, në atë kohë, shton Hajdari, kanë marrë vendim për ta angazhuar ekipin e avokatëve që do të ndihmonin për ta zgjidhur çështjen. "Kemi shpresuar se me përkushtimin tonë do të gjejmë zgjidhje të favorshme pa pasur nevojë për arbitrazh. Qeveria e tanishme nuk ka dashur zgjidhje në të mirë të Kosovës. Gjithsesi, Kosova duhet t'i kërkojë përgjegjësi 'ContourGlobal'-it, duke mos kursyer mjetet juridike", thotë ajo.

### Si mund të përfundojë ky proces?

Hajdari thotë se në këtë proces Kosova mund të dalë fitimtare nëse këtë çështje ua lë në dorë profesionistëve që mbrojnë të drejtat ligjore dhe interesin publik. "Politikanët e papërgjegjshëm dhe pazaret politike mund ta dëmtojnë ecurinë, ashtu siç e kanë shkaktuar atë që në fillim", thotë ajo.

Ndërkaq, ish-ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, i ka thënë shkurt "Radios Evropa e Lirë" se kur ka ndodhur tërheqja e kompanisë "ContourGlobal" nuk ka qenë pjesë e qeverisë por, sipas tij, qeveria është dashur që lidhur me këtë çështje, të konsultohet me këshilltarët ligjorë për të diskutuar për hapat prej muajit mars. "Radio Evropa e Lirë" ka dërguar pyetje në kompaninë "ContourGlobal"

→



lidhur me këtë çështje, por deri në publikimin e këtij shkrimi ajo nuk ka kthyer përgjigje.

### Po shqyrtohet dokumentacioni i kontestit

Qeveria e Kosovës tanimë në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit kanë marrë masa që ky proces në arbitrazhin ndërkombëtar të ndiqet dhe çështja të mbrohet në mënyrën më të mirë të mundshme.
Avokati i përgjithshëm shtetëror i Kosovës, Sami Istrefi, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se po përgatiten se si do t'i qasen këtij kontesti. "Kompania në fjalë ka pasur një raport kontraktual me shtetin e Kosovës në të gjitha fazat nga faza fillestare deri te fizibiliteti dhe çështjet e tjera. Është e vërtetë që kompania është tërhequr nga ndërtimi i Termocentralit 'Kosova e Re'. Ne jemi duke analizuar marrëveshjen që shteti i Kosovës ka pasur me këtë kompani dhe pas shqyrtimit të përgjithshëm të këtyre marrëveshjeve, ne mund të nxjerrim një konkluzion se cila është kërkesa fillestare e saj, ku bazohet dhe cilat janë ato elemente për ta kundërshtuar këtë padi", tha Istrefi.

### OEAK-u: Fajtore Kosova për tërheqjen e 'ContourGlobal'-it

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se ka qenë shteti i Kosovës që nuk ka arritur t'i përmbushë detyrimet, gjë e cila, sipas tij, ka nxitur edhe largimin e kompanisë nga projekti i ndërtimit të Termocentralit "Kosova e Re".
Kosova, shton ai, ka dështuar ta sigurojë aprovimin përfundimtar nga ana e Kuvendit të Kosovës për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re". "Njoftimi për tërheqje nga një projekt i tillë ka ndodhur në rrethana kur partitë politike dhe deputetë të Kuvendit kanë deklaruar haptas se nuk do ta aprovojnë të njëjtën marrëveshje kurdo që ajo të sillet në Kuvendin e Kosovës", thotë Zeka.
Vlen të theksohet se garancia shtetërore për pakon financiare për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" kërkonte 2/3 e votave të deputetëve të Kosovës.
Kosova, shton Zeka, përtej një dëmi të mundshëm financiar për të cilin mund të detyrohet ta kompensojë, ka humbur mundësinë që t'i fuqizojë kapacitetet e saj vendore për gjenerim të energjisë elektrike. "Kur bëhet fjalë për projekte të tilla si Termocentrali 'Kosova e Re', duhet të ketë konsensus nacional dhe dinamikë më të shpejtë dhe realizim të këtyre projekteve që në Kosovë kanë munguar", shton Zeka. Lajmi për tërheqjen e kompanisë "ContourGlobal" nga ndërtimi i Termocentralit "Kosova e Re" ishte mirëpritur nga përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët e konsideronin si një projekt të dëmshëm për mjedisin dhe qytetarët.

### Termocentrali "Kosova e Re"

Qeveria e Kosovës ka nënshkruar në fund të vitit 2017 marrëveshjen komerciale me kompaninë amerikane "ContourGlobal" për ndërtimin e këtij termocentrali me kapacitet 500 megavat, i cili do të kushtonte 1.3 miliard euro. Si i tillë, ky projekt përfaqësonte investimin më të madh të huaj në Kosovë.
Termocentrali "Kosova e Re" ishte paraparë të fillonte të ndërtohej në këtë vit, ndërsa të vihet në punë në vitin 2023. Jetëgjatësia e termocentralit "Kosova e Re" ishte llogaritur të jetë 40 vjet.
Termocentrali "Kosova e Re" ishte kundërshtuar nga disa përfaqësues të shoqërisë civile. Kosova ka më shumë se 10 miliardë tonë linjit dhe, si i tillë, është vendi i pestë në botë për nga sasia e këtij resursi por, me gjithë pasurinë e linjitit, Kosova vazhdon të përballet me mungesë të energjisë elektrike.

# Osmani dekreton Ligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike

**Prishtinë, 6 dhjetor** - Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike, i cili u miratua në Kuvendin e Kosovës më 4 dhjetor, është dekretuar nga ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani dhe tashmë si ligj do të nisë të zbatohet pasi që të publikohet në Gazetën Zyrtare. Lajmin e ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë", këshilltari i Osmanit, Artan Murati. "Ligji është dekretuar dje (të shtunën)", ka thënë Murati.




Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike është plotësim dhe ndryshim i disa ligjeve, me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Ai është votuar nga 72 deputetë të Kuvendit të Kosovës, ndërkaq që nuk është përkrahur nga deputetët e subjektit më të madh opozitar, Lëvizjes Vetëvendosje.
Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se ky ligj kap shifrën e rreth 600 milionë eurove. Ky ligj parasheh që kontributpaguesit mund t'i tërheqin 10 për qind të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.
Sipas këtij ligji, kontributpaguesit që kanë kursime pensionale deri në shumën 10 mijë euro, në rast të tërheqjes së 10-përqindëshit nga ana e tyre, Qeveria e Kosovës do ta kompensojë atë brenda pesë vjetëve të ardhshme.
Sipas këtij ligji, të gjithë punëtorët e sektorit privat të regjistruar si të papunë, e që kanë qenë në marrëdhënie pune deri në shtator 2020, por që nga muaji tetor 2020 janë liruar nga punëdhënësi si pasojë e ndikimit të Covid -19, do të paguhen nga ana e qeverisë së paku tre deri në katër muaj përkatës.
Po në bazë të ligjit do të themelohet granti në shumën prej 200 milionë eurosh, për ndihmë direkte financiare bizneseve, të cilat kanë vështirësi funksionimi si rezultat i ndikimit të Covid-19, ndërkaq që Qeveria e Kosovës do ta lirojë nga TVSh-ja lëndën e parë, e cila prodhohet nga bizneset e Kosovës, pavarësisht se a eksportohet jashtë vendit apo jo.
Ky ligj parasheh edhe një sërë masash të tjera lehtësuese për bizneset në Kosovë.
Sipas Kushtetutës së Kosovës, pasi një ligj dekretohet nga presidenti ai publikohet në Gazetën Zyrtare. Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse në vetë ligjin nuk përcaktohet ndryshe.

## Aplikimi për tërheqjen e mjeteve nga Trusti do të zgjasë katër muaj

Trusti Pensional i Kosovës ka njoftuar të gjithë kontributdhënësit se afati për aplikimin e tërheqjes së 10-përqindëshit do të zgjasë katër muaj. "Tërheqja prej 10 përqindësh është dekretuar sot si pjesë e Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike. Aplikimi për tërheqje të 10 për qind do të bëhet vetëm online dhe përmes një faqeje të veçantë interneti. Pra, nuk keni nevojë që tani të krijoni qasje në e-Trusti. Adresa e faqes së veçantë të internetit për aplikim të tërheqjes 10 për qind dhe detajet e tjera do të publikohen në ditët në vijim. Për aplikim janë në dispozicion katër muaj. Prandaj, mos u brengosni nëse nuk mund të aplikoni që në ditët e para pas dekretimit", ka njoftuar Trusti.

# Abrashi: Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugës Prishtinë - Grashticë do të bëhet me të gjitha standardet

**Prishtinë, 6 dhjetor (ER)** - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka vizituar kompaninë projektuese që është duke i bërë matjet gjeodezike për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugës Prishtinë - Grashticë.
Ministri Abrashi tha se kjo rrugë përfshinë projektimin dhe pastaj tenderimin e fazës së parë, që do të bëhet me të gjitha standardet për qarkullim. "Fillimisht jemi të orientuar ta hartojmë projektin për pjesën Prishtinë - Grashticë dhe pastaj vazhdimin e projektimit deri në Mutivodë. Synojmë që pjesa hyrëse në kryeqytet të rehabilitohet sa më parë", ka thënë Abrashi, duke shtuar se projekti parasheh zgjerimin dhe rehabilitimin, trotuaret dhe shtigjet e çiklistëve. "Me një fjalë, do të jetë rrugë model me të gjitha standardet", ka deklaruar



Abrashi.
Ai bëri me dije se shumë shpejt do të nënshkruhet memorandumi në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Prishtinës, që parasheh bashkëpunim edhe për këtë rruge.
Abrashi ka theksuar se zgjerimi i këtij aksi do të ketë ndikim të shumëanshëm te banorët e Prishtinës. "Kjo rrugë do të ketë ndikim në rritjen e turizmit, në lidhjen më të mirë në mes të fshatrave të Gollakut dhe Anamoravës, po ashtu me pikën kufitare të Mutivodës", është shprehur Abrashi.
Kjo është faza e parë e zgjerimit të rrugës Nacionale N9, segmenti Prishtinë-Mutivodë, konkretisht nga vendi i njohur si banesat e socialit deri në drejtim të Grashticës.

# Vdes një i burgosur në spitalin e Pejës

Pejë, 6 dhjetor (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se në spitalin rajonal të Pejës ka ndërruar jetë i burgosuri M. H., viti i lindjes 1935. I burgosuri, nga data 02.12.2020, me rekomandim të mjekut të Q. K Dubravë, është shtrirë në spitalin rajonal të Pejës ku, përkundër ofrimit të ndihmës mjekësore, i njëjti ka ndërruar jetë. "M. H nga fillimi i mbajtjes së dënimit ka pasur probleme shëndetësore në zemër, diabet dhe sëmundje me komplikime të tjera. Si pasojë e sëmundjeve dhe moshës, i njëjti tërë kohën ka qenë i vendosur në Stacionarin e Qendrës Korrektuese Dubravë dhe është trajtuar nga mjekët në këtë institucion, në Spitalin e Pejës dhe në ShSKUK. I njëjti ishte i dënuar me dhjetë vjet burgim për veprën penale 'keqpërdorim seksual nën moshën 16-vjeçare'. Organet kompetente janë duke i zhvilluar procedurat ligjore, ndërsa autopsia do ta verifikojë shkakun e vdekjes", ka njoftuar Shërbimi Korrektues i Kosovës.



## Qendra Rajonale e Rinisë në Gjakovë funksionalizohet në pranverën e vitit të ardhshëm



Gjakovë, 6 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka vizituar Qendrën Rajonale të Rinisë në të cilën po punohet për finalizimin e objekteve që do të jenë në shërbim të të rinjve. Dorina Lluka Davies, drejtoreshë e YMCA, ka informuar për realizimin e punimeve. Gjithashtu, u vizituan hapësirat e shtëpive që tashmë janë në proces të inventarizimit, amfiteatri dhe hapësira të tjera që do të shërbejnë për rekreacion dhe promovim të kulturave të ndryshme botërore. Kjo qendër pritet të funksionalizohet në tërësi në pranverën e vitit të ardhshëm.

## Komuna e Ferizajt falënderon stafin teknik shëndetësor që po ndihmon në përballjen me pandeminë

Ferizaj, 6 nëntor (ER) - Përpjekja për menaxhimin më të mirë të pandemisë së virusit Covid-19, përveç nga mantelbardhët në institucionet lokale shëndetësore, që nga fillimi i pandemisë nuk ka munguar as nga ana e stafit teknik të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajt, të cilët çdo ditë, bashkë me mantelbardhët, janë në frontin e kësaj beteje për shëndetin e qytetarëve. Komuna e Ferizaj ka shprehur mirënjohje e respekt të pafund për të gjithë të angazhuarit rreth kësaj situate.



# Kastrati: Nuk ka çmim që e paguan punën e vullnetarëve

Kamenicë, 6 dhjetor (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka takuar disa nga vullnetarët që kanë kontribuuar vazhdimisht në këtë periudhë, ku i gjithë vendi po përballet me pandeminë Covid-19. Sipas Kastratit, nuk ka asnjë çmim që mund ta paguajë punën e vullnetarëve por, për t'ua shprehur falënderimin për kontributin e pashoq, ai u ka ndarë mirënjohje secilit prej tyre. "Sot në Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit kam takuar dhe u kam ndarë mirënjohje të gjithë vullnetarëve që punuan pa ndalur në këtë periudhë të pandemisë, duke filluar nga ana logjistike e deri tek ajo profesionale", ka thënë ai.



I pari i komunës ka pohuar se ndihet krenar me secilin prej tyre, duke filluar nga ata që janë marrë me logjistikë e deri tek ata që kontributin e tyre e kanë dhënë në nivel profesional. "Faleminderit që ishit pranë secilës familje kur kishin nevojë, kurse ju doktorë e infermierë, faleminderit që i dolët në krah stafit shëndetësor në momentet më të vështira", është shprehur Kastrati.

Për shkak të pandemisë dhe mbylljes që ndodhi në nivel vendi, vullnetarë të shumtë janë lajmëruar që të asistojnë aty ku ka nevojë. Në mesin e tyre, doktorë, infermierë, laborantë, studentë nga fusha të ndryshme, e shumë qytetarë që ofruan në dispozicion çfarëdo që ishte nevoja.

# NGA BARAZIMI I KRIMEVE PO SHKOHET NË BARAZIMIN E VIKTIMAVE!

Me këtë mosunitet skandaloz politik dhe institucional në Prishtinë dhe me këtë stil defanziv e përçarës të mediave të Kosovës, Serbia një ditë të bukur me diell mund të gdhijë si një mur vajtimi mbi të cilin duhet të derdhen lotët e dhembjes për krimet e supozuara të shqiptarëve mbi serbët. Nëse një kohë të gjatë ka funksionuar fabula mbi ujkun dhe qengjin, ku i ky i fundit e paska pas turbulluar ujin, pse të mos funksionojë edhe sot propaganda e Beogradit mbi viktimat serbe si alibi e fshehjes së krimeve të vërteta të kryera nga ana makineria pushtuese e Serbisë!?



Nga Mehmet PRISHTINA

Në Serbi kohën e fundit po flitet edhe për serbë të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ky diskurs ka për qëllim nivelizimin e krimit, duke dashur t'i paraqiten botës dy pamje simetrike, në të cilat viktimat nuk janë vetëm nga radhët e shqiptarëve, por edhe të serbëve. Edhe në aktakuzat e fundit të ngritura kundër ish-krerëve të UÇK-së në Gjykatën Speciale në Hagë përvijohet tendenca e barazimit të krimeve mbi baza të ndryshme etnike.

Gërmimet e fundit në Kizhevak afër Beogradit, sipas mediave serbe, konsiderohen si plagë e hapur për familjet e viktimave në Serbi. Hetuesit arritën ta gjejnë vendndodhjen pas shumë vitesh kërkimi me ndihmën e Kryqit të Kuq. Zyrtarët thonë se dyshojnë për 15 deri në 17 kufoma.

Nga ana e tyre, zyrtarët serbë në Beograd duan ta bindin publikun se çdo informatë do të verifikohet. "Në Londër, Uashington, dhe Bruksel në kuadër të dialogut jemi pajtuar dhe kemi marrë obligim që të punojmë në mënyrë transparente dhe t'i shkojmë deri në fund këtij procesi", tha Velko Odalloviq nga Komisioni për të Zhdukurit i Qeverisë së Serbisë.

Aktivistë të shoqërisë civile në Kosovë pretendojnë se ekzistojnë edhe disa varreza masive në territorin e Serbisë, ndërkohë që statistikat zyrtare thonë se si të zhdukur në luftën e Kosovës konsiderohen 1 638 veta. Shumica janë shqiptarë, por Beogradi insiston se në mesin e tyre ka edhe rreth 300 serbë.

Në një vështrim të agjencisë "Reuters" thuhet se kërkimi për viktimat mbeten një pengesë kryesore për përmirësimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Varri masiv më i madh i gjetur deri më tani, që mbante trupat e më shumë se 800 shqiptarëve të Kosovës, u gjet në 2001 në një kompleks policie afër Beogradit.

Sipas "Reuters"-it, mbetjet mortore që besohet të jenë trupat e disa shqiptarëve të vrarë gjatë luftës 1998-'99 në Kosovë janë gjetur brenda Serbisë. Më shumë se dy dekada pasi përfundoi konflikti në Kosovë, kërkimi për viktimat mbetet pengesë kryesore për përmirësimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës. Hetuesit përdorën imazhet satelitore për ta gjetur varrin masiv në një minierë të hapur në Kizhevak në jug të Serbisë. Gjetjet e tyre sugjeruan se mund të kishte deri në 17 trupa, siç u tha gazetarëve Veljko Odaloviq, kreu i Komisionit të Serbisë për Personat e Zhdukur.

Më shumë se 13 000 njerëz besohet të kenë vdekur gjatë luftës në Kosovë. Shumica e viktimave ishin shqiptarë etnikë dhe qindra janë ende të zhdukur. Serbia ka aplikuar për të qenë anëtare e Bashkimit Evropian dhe Kosova gjithashtu dëshiron të jetë pjesë e BE-së por, sipas "Reuters"-it, të dyja duhet t'i normalizojnë marrëdhëniet. A mund të ndodhë që Serbia ta marrë dritën jeshile për datën e fillimit të negociatave me BE-në edhe pa e përmbushur kushtin kryesor, gjetjen e të gjitha varreve masive me shqiptarë të masakruar dhe dënimin e të gjithë atyre që shkaktuan mijëra vdekje në Kosovë?

Por, si po i qaset këtij problemi elita e Kosovës dhe sa është ajo aktive për prishjen e kësaj skeme të imponuar nga Beogradi i cili po synon barazimin e viktimave, duke i pamundësuar Kosovës ta ngrejë zërin për padrejtësitë që ia janë bërë nga soldateska kriminale e Serbisë.

Deri më tani nuk ka ndodhur që Kosova të bllokojë çfarëdo nisme të Serbisë për t'u integruar në mekanizmat e ndryshëm ndërkombëtarë. Por, ka ndodhur e kundërta. Serbia ka qenë ajo e cila me politikën agresive dhe tepër joparimore ka bllokuar disa përpjekje të Kosovës për t'u përfshirë në INTERPOL, në UNESCO dhe në disa organizata të rëndësishme ndërkombëtare.

Për çka flet kjo?

Në Prishtinë aktualisht temë qendrore është se kush do të bëhet president i ardhshëm i vendit. Të gjithë e synojnë këtë post dhe të gjithë duan përfitime nga posti që do të marrin. Me fjalë të tjera, lufta gati kanibaliste për pushtet po tregohet më e theksuar se menaxhimi me pushtetin në dobi të interesit publik. Ka kohë që në Kosovë interesi publik është zëvendësuar me interesa partiake e klanore dhe në këtë mënyrë copëzimi dhe fragmentimi i shoqërisë së Kosovës po shndërrohen në guralecë në këpucët e grisura të politikanëve të papërgjegjshëm.

Diskursi publik në Serbi, i prezantuar madje edhe nga presidenti Vuçiq, i cili kur komentoi situatën politike në Kosovë tha se "atje të gjithë duan të bëhen president", dëshmon për paqëndrueshmërinë e diplomacisë dhe propagandës së Kosovës. Kjo e fundit në botë është paraqitur si një fëmijë i përlotur me vaj në buzë, që kërkon lëmoshë për dëmet që i janë bërë, por pa ofruar kurrfarë dosje me dëshmi në gjykatat ndërkombëtare për krimet serbe të bëra para 20 vjetëve në Kosovë.

Në anën tjetër, diplomacia dhe mediat serbe kanë aktivizuar fushatën e tyre për paraqitjen e Kosovës si vilajet i errët ku vuajtjet serbe paraqiten si lajtmotiv kryesor i gjoja krimeve që kanë bërë shqiptarët.

Me këtë mosunitet skandaloz politik dhe institucional në Prishtinë dhe me këtë stil defanziv e përçarës të mediave të Kosovës, Serbia një ditë të bukur me diell mund të gdhijë si një mur vajtimi mbi të cilin duhet të derdhen lotët e dhembjes për krimet e supozuara të shqiptarëve mbi serbët.

Nëse një kohë të gjatë ka funksionuar fabula mbi ujkun dhe qengjin, ku i ky i fundit e paska pas turbulluar ujin, pse të mos funksionojë edhe sot propaganda e Beogradit mbi viktimat serbe si alibi e fshehjes së krimeve të vërteta të kryera nga ana makineria pushtuese e Serbisë!?

# Asfaltohen rrugicat në fshatin Shalë të Lipjanit



Lipjan, 6 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka qëndruar në fshatin Shalë, ku ka parë nga afër punimet që janë duke u zhvilluar nëpër asfaltimin e rrugicave të këtij fshati.

Kryetari Ahmeti ka uruar banorët e fshatit Shalë për asfaltimin e këtyre rrugicave dhe ka thënë se do të angazhohet vazhdimisht për realizimin e shumë projekteve që janë me rëndësi jetike për banorët e Shalës dhe për qytetarët lipjanas në përgjithësi. Ky projekt është investim i Komunës së Lipjanit dhe ka kushtuar 49 839.25 euro.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Montimi
Servisimi
Porosi
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Drita e zbret Ballkanin nga froni

Drita e ka fituar derbin e zhvilluar në Gjilan kundër Ballkanit dhe në këtë mënyrë e ka rrëmbyer pozitën e parë në Superligë. Më meritori për fitoren e kampionëve në fuqi ishte sulmuesi Kastriot Rexha, i cili realizoi dy golat e fitores



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Kampionia në fuqi e Superligës, Drita, e ka mposhtur në derbi Ballkanin (2-1) dhe në këtë mënyrë e ka rrëmbyer pozitën e parë në tabelë. Kjo pozitë është mbajtur deri tash nga skuadra e Ballkanit. "Një ndeshje e luftuar shumë nga futbollistët, shumë dëshirë dhe shpirti luftarak i grupit na solli te fitorja. Kishim një kundërshtar të fortë që na vuri në vështirësi, por ne ishim më të saktë dhe arritëm të fitojmë. Pra, përvoja dhe shpirti luftarak i grupit na sollën fitoren", ka thënë Ardian Nuhiu, trajner i Dritës.

Tre golat e kësaj ndeshje derbi janë realizuar në pjesën e parë. Pas gjysmë ore lojë, Drita kaloi në epërsi me golin që shënoi Kastriot Rexha me kokë. Në minutën e 44-t Ballkani barazoi shifrat 1-1 nëpërmjet sulmuesit më të mirë në elitë, Mirlind Daku. Epërsinë e vendësve e riktheu Kastriot Rexha, i cili realizoi golin e dytë në këtë ndeshje. Në pjesën e dytë u regjistruan edhe disa raste shënimi dhe u anulua një gol i vendësve për shkak të pozitës jashtë lojës dhe në fund ndeshja përfundoi me rezultat 2-1. Tash Drita është lidere me 36 pikë, kurse Ballkani bie në pozitën e dytë me një pikë me pak se skuadra gjilanase. "Paraqitja ishte e mirë, e kënaqshme, pa dy episodet ku edhe kemi stërvitur më së shumti, edhe aty një pakujdesi, por edhe zotësia e Kastriot Rexhës bëri të dështojmë. Jam i kënaqur me paraqitjen e skuadrës. Vazhdojmë tutje. Pra në ato dy episode duhet të ishim më të vëmendshëm. Me lojën, me angazhimin, me paraqitjen dhe me referimin jam i kënaqur", ka thënë Ismet Munishi, trajner i Ballkanit.

Në ndeshjen tjetër të zhvilluar të dielën, Llapi e ka fituar përballjen me Besën e Pejës (2-0). Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" ishte një përballje mes dy skuadrave të fundit në tabelë. Llapi e nisi mirë ndeshjen dhe realizoi pas tre minutave nëpërmjet Valmir Veliut. Shtatë minuta më vonë, Engjell Hoti realizoi për 2-0. Edhe në minutat në vazhdim të ndeshjes rastet nuk munguan, por gola të tjerë nuk pati dhe skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina iu gëzua fitores.

Llapi, pas këtyre tri pikëve, ngrehet kuotën e 14 pikëve dhe vazhdon të pozicionohet në vendin e parafundit, kurse Besa ka grumbulluar vetëm gjashtë pikë dhe pozicionohet e fundit. Të shtunën në Mitrovicë, Trepça '89 arriti fitore me rezultat bindës ndaj Gjilanit (3-0). Golashënues për '89-shin ishin Arbnor Muja, Sie Bissmark dhe Rilind Nimani. Në anën tjetër, Arbëria e mposhti Drenicën me rezultat minimal 1-0, kurse golin e fitores e realizoi në minutën e fundit të ndeshjes, Hysen Bytyqi. Në xhiron e gjashtëmbëdhjetë janë takuar edhe Prishtina dhe Feronikeli, të cilët kanë luajtur baras 0-0.

**SUPERLIGA - Java e 16**

| | |
|---|---|
| Drita - Ballkani | 2-1 |
| Llapi - Besa | 2-0 |
| Trepça '89 - Gjilani | 3-0 |
| Arbëria - Drenica | 1-0 |
| Prishtina - Feronikeli | 0-0 |

**Tabela**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Drita | 15 | 36 pikë |
| 2. Ballkani | 15 | 35 |
| 3. Prishtina | 15 | 25 |
| 4. Gjilani | 15 | 23 |
| 5. Feronikeli | 16 | 20 |
| 6. Arbëria | 16 | 20 |
| 7. Trepça '89 | 16 | 20 |
| 8. Drenica | 16 | 18 |
| 9. Llapi | 16 | 14 |
| 10. Besa | 16 | 6 |

Në xhiron e radhës takohen: Gjilani-Prishtina, Drenica-Drita, Feronikeli-Besa, Ballkani-Trepça '89, Arbëria-Llapi.

## SHKURT

### Më 18 dhjetor mbahet Kuvendi i Rregullt Zgjedhor i FBK-së

Bordi i Federatës i Basketbollit të Kosovës (FBK) ka vendosur që Kuvendi i Rregullt Zgjedhor i FBK-së të mbahet më 18 dhjetor në orën 15:00 në Hotel "Four Points by Sheraton Prishtina". Afati për nominime për kryetar të FBK-së është i hapur deri të premten, më 11 dhjetor në orën 16:00 dhe fletënominimet duhet të dorëzohen fizikisht në zyrat e FBK-së nga përfaqësuesit e autorizuar të anëtarëve të Kuvendit. Materialet për Kuvendin e Rregullt Zgjedhor delegatëve do t'u dërgohen në mënyrë elektronike sipas afateve të parapara me aktet normative të FBK-së.

### Besa Famgas dhe Prishtina fitojnë pa telashe

Besa Famgas dhe Prishtina kanë shënuar fitore të thella në ndeshjet e javës së 11-të të Superligës së hendbollistëve, të luajtura të shtunën. Kampionia aktuale, Besa Famgas, e mposhti në Pejë skuadrën gjakovare të Vëllaznimit me rezultat 35:13. Ndërkohë Prishtina në kryeqytet fitoi ndaj Prizrenit me rezultat 46:25. Besa Famgas udhëheq në tabelë me 22 pikë, kurse Prishtina është e dyta me 20 pikë.

### Të martën shorti për 1/16 e finales së Kupës në futboll

Të martën (më 8 dhjetor) në orën 13:00 në selinë e FFK-së do të bëhet tërheqja e shortit për rrethin e 1/16 së finales së Kupës së Kosovës në futboll. Në këtë rreth do të marrin pjesë 32 skuadra, ku do të përfshihen klubet e Superligës e të Ligës së Parë, si dhe dy skuadrat që e kanë siguruar kalimin në këtë rreth nga tri fazat e para ku ishin të përfshira klubet e Ligës së Dytë dhe Ligës së Tretë. Shorti ishte paraparë të mbahej më 26 nëntor, por me kërkesë të klubeve ishte shtyrë. Fituese e Kupës së edicionit të kaluar është Prishtina.

### Zbulohet testamenti i Maradonës

Sipas lajmeve të bujshme që vijnë nga mediat argjentinase, duket se Diego Armando Maradona ka përjashtuar tre familjarë nga testamenti i tij për përfitimet e milionave që la pas. Bëhet fjalë për ish-gruan Klaudia Villafane dhe dy vajzat Dalma dhe Gianina. Është me të vërtetë tronditës lajmi i publikuar nga mediat e huaja. Gazetarët kanë treguar edhe përmbajtjen e dokumentit të redaktuar nga ish-Pibe de Oro në 2016-n në Dubai. Marrëdhëniet mes Maradonas dhe vajzave të tij të para nuk ishin aspak të mira.

## Peja nuk di për humbje

PEJË, 6 DHJETOR - KB Peja ka shënuar fitoren e pestë në pesë ndeshje të zhvilluara në këtë edicion në Prince Caffe Superligë. Pejanët kanë mundur si mysafir Trepçën 58:72 (17:14, 13:16, 9:21, 19:21) në ndeshjen e mbetur të xhiros së pestë. Çereku i parë ishte i baraspeshuar me vendësit që u treguan paksa më të mirë, duke e fituar këtë pjesë 17:14. Por, verdhezinjtë iu përgjigjen në periodën e dytë 13:16 dhe skuadrat shkuan në pushim me rezultat 30:30. Dallimi u bë në periudhën e tretë, ku pejanët fituan 9:21 dhe epërsinë e krijuar e ruajtën deri në fund për të triumfuar 58:72, duke mbetur skuadra e vetme në Superligë me pesë fitore, kurse mitrovicasit kanë dy fitore dhe tri humbje. Te Trepça u dalluan Kalin Fisher me 19 pikë dhe Burim Zekiqi me 12, kurse te Peja u dalluan Dardan Berisha me 18 pikë, nëntë kërcime dhe tetë asistime dhe Amel Kuljuhoviq me 12 pikë e 10 kërcime.



# EUBC-ja uron Federatën e Boksit të Kosovës për sukseset e arritura



PRISHTINË, 6 DHJETOR - Presidenti i Federatës Evropiane i Boksit EUBC, Feanco Francinelline, e ka përgëzuar Federatën e Boksit të Kosovës për rezultatet e arritura në garat evropiane gjatë këtij viti edhe përkundër situatës së vështirë për shkak të pandemisë Covid-19. Ai, ndër të tjera, ka potencuar guximin e federatës për të dërguar atletë në garat evropiane. "Në fund të sezonit konkurrues 2020, në emër të Komitetit Ekzekutiv të EUBC, dëshiroj t'i shpreh urimet e mia për arritjen e rezultateve teknike të shkëlqyera në Kampionatin Evropian të Boksit për të Rinj 'Budva 2020' dhe Junior European Kampionati i Boksit 'Sofia 2020'. Duke admiruar guximin tuaj për të sfiduar Covid-19 duke dërguar atletët tuaj në gara, ju përcjellë urimet e mia më të ngrohta për fitimin e medaljeve prestigjioze në boksierët në listën më poshtë. Me shpresën për të arritur suksese të mëtejshme, ju dërgoj përshëndetjet e mia më të përzemërta", thuhet në letrën e presidentit të EUBC-së, Feanco Francinelline.

Federata e Boksit e Kosovës arriti sukses të madh në dy kampionatet evropiane 2020. Medalja e bronztë, vendi i 3 Remzo Mustafiq 91 kg në Kampionatin Evropian për të Rinj U18 në Budva (Mali i Zi) dhe medalja e argjendtë, vendi i dytë Alnera Brahimi, 70 kg, në Kampionatin Evropian për Juniorë U16 në Sofje (Bullgari).

# Mick Schumacheri, kampion në Formula 2

MANAMA, 6 DHJETOR - Mick Schumacheri ka fituar titullin e kampionit në serinë Formula 2. Djali i legjendës së Formula 1, Michael Schumacher, ka siguruar titullin e kampionit pas një gare dramatike të dielën në Bahrejn. Mickut i ka mjaftuar një pozitë e 18-të në garën për ta fituar titullin e kampionit. Rivali i vetëm Callum Ilott (22) ka përfunduar i dhjeti. Callumit i duhej fitorja për ta kaluar Schumacherin. "Nuk kam fjalë. Shumë faleminderit!", ka thënë Mick Schumacher. Mick Schumacher është gjermani i parë që nga viti 2009 që e ka fituar titullin e kampionit në Formula 2.




## Balotelli sot kryen testet mjekësore te Monza

Mario Balotelli sot (e hënë) do t'i kryejë testet mjekësore në skuadrën e Monzas që garon në Serinë B. Sulmuesi 29-vjeçar që ka një karrierë të pasur futbollistike me klubin italian do të nënshkruajë kontratë deri në fund të këtij kampionati, por me mundësi rinovimi edhe për një vit tjetër. "Falënderoj presidentin Berlusconi dhe Adriano Gallianin për këtë mundësi që më dhanë. Do të bëj gjithçka në fushën e lojës për ta ngjitur Monzën menjëherë në Serinë A", ka thënë Balotelli.

## SHKURT

### Inzaghi: Strakosha është portieri kryesor i Lazios

Trajneri i Lazios, Simone Inzaghi, është pyetur nga gazetarët rreth paraqitjeve të mira të portierit spanjoll Pepe Reina dhe mbetjes në bankën rezervë të portierit shqiptar Thomas Strakosha. "Strakosha ka pasur Covid-19. Kur të përmirësohet gjendja e tij, do të kthehet në formacionin bazë. Në këtë moment Reina po luan mirë dhe është pikë referimi për shokët e tij dhe për këtë arsye kam zgjedhur atë. Reina ka luajtur mirë, por nuk harroj Strakoshën. Ai ishte njëri nga më të mirët në Serinë A vitet e fundit. Ai është portieri kryesor", ka thënë Inzaghi.

### Koeman: Humbja nga Cadizi, vështirë të shpjegohet

Barcelona u mposht me rezultatin 2-1 nga Cadizi. Trajneri i katalanasve, Ronald Koeman, nuk ka mundur ta shpjegojë këtë disfatë dhe ia lë fajin mospërqendrimit të lojtarëve. Holandezi e pranon se ky ishte një hap prapa në luftën në La Liga. "Është e vështirë të shpjegohet. Vinim në këtë ndeshje nga rezultate të mira. Pjesa e parë nuk ishte shumë e mirë për ne. Në të dytën ishim pak më mirë, por është e pabesueshme që kemi humbur nga një gabim që nuk pritej. Është çështje mospërqendrimi", ka thënë Koeman. "Ishte një hap gjigant prapa në shanset tona në kampionat. Duhet ta pranojmë që jemi 12 pikë larg Atleticos dhe me të vërtetë që është shumë. Ka ende shumë ndeshje, por nëse nuk i përmirësojmë këto ulje-ngritjet që kemi në transferta, nuk kam se çfarë të them", ka deklaruar trajneri holandez.

### Zidane: Realin nuk do ta mposhtë më askush

Real Madridi fitoi me rezultat 0-1 në fushën e Sevillas. Trajneri i "Los Blancos", Zinedine Zidane, pas fitores ndaj skuadrës andaluziane, ka vlerësuar karakterin e lojtarëve të tij, të cilët vinin nga dy humbje radhazi. "Ishte një ndeshje e bukur. Vuajtëm në pjesën e dytë, por ka rëndësi të madhe të dish të vuash dhe sakrifikosh. Jam i kënaqur për djemtë, pasi ditët e fundit nuk kanë qenë aspak të lehta për ta. Jemi një skuadër me karakter të fortë. Sigurisht se nuk ndikon për mirë fakti që luajmë çdo tri ditë, por ne nuk ndalemi kurrë. Rëndësi ka të rikuperohemi fizikisht dhe të mendojmë për ndeshjen tjetër. E dimë që kemi disa probleme, por kur t'i rregullojmë do ta kenë të vështirë ta na mposhtin", ka thënë Zidane.

### PSG-ja largon Jesen

Pas katër vjetësh e gjysmë ka ardhur momenti i ndarjes mes PSG-së dhe Jese Rodriguez, prej kohësh i ndarë në shtëpi dhe kurrë në planet e trajnerit Thomas Tuchelit. Klubi francez nëpërmjet një komunikate ka bërë me dije se ka zgjidhur në mirëkuptim me lojtarin kontratën që i lidhte palët deri më 30 qershor 2021.

Sipas shtypit francez, ky vendim nuk është marrë për probleme që janë verifikuar jashtë fushës, pavarësisht prej pjesëmarrjes së Jeses kohët e fundit në një "reality show" nëpërmjet telefonit nuk është pëlqyer shumë nga klubi. Lojtari dhe klubi kishin vendosur të ndaheshin pas katër vjetësh e gjysmë të kaluara më shumë në huazim nëpër Evropë, me përjashtim të disa paraqitjeve të rralla në Paris. Jese gjatë këtyre katër vjetëve e gjysmë ka veshur fanellat e Las Palmas, Stokes, Betisit dhe Sportingut. Ai u transferuar te PSG-ja nga Real Madridi për 25 milionë euro në 2016-n.

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

İş Kanunu Madde 8 uyarınca No. 03 / L-212, yürütme konseyinin Mamuşa Belediyesi Aile Hekimliği Merkezi –AHM Mamuşa No.01/2016 kararlarına istinaden Belediye Başkanlığı No.38-16 tarihli 07.12.2020. Sağlık ve Sosyal Refah Müdürlüğünün ilanı::

**K O N K U R U**
ilan etmektedir

**Görevin adı: Genel pratisyenler - Tıp doktoru (iki yer)**
**Katsayısı:** H-565
**Rapor verdiği kişi:** Sağlık müdürü
**Sözleşme:** Deneme ve uzatma sürecini için olarak (1) yıl
**Çalışma saatleri:**Tam
**Kalifikasyon:** Tıp Fakültesi'nden mezun olması, yasa gereği staj ve lisanslı.

**Görevin adı: Hemşire (iki yer)**
**Katsayısı:** H-377
**Rapor verdiği kişi:** Sağlık müdürü
**Sözleşme:** Deneme ve uzatma sürecini için olarak (1) yıl
**Çalışma saatleri:** Tam
**Kalifikasyon:** İlk ve Acil Yardım Ön lisans yada Tıp Meslek lisesi mezun olması, yasa gereği staj ve lisanslı.

**Tüm başvuruda bulunma için ilgilenen adayların şu koşulları doldurması gerekir:**
1. Kosova Cumhuriyeti vatandaşı olmalarsı.
2. Kimlik kopyası ve doğum belgesi
3. Diploma kopyası noterden onaylı
4. Lisanslı;
5. Suçlama ve mahküm olmamalı belgesi,
6. Sağlık sertifikası.

**Başvuruların alımı ve teslimi:**
Başvuru formları Mamuşa Belediye Sağlık Şefinde alınır ve katılmış olduğunuz görev için vazife ve sorumluluklar da müracaata leffedilmiştir.

**Konkur günlük gazetede yayınlandıktan sonra 15 gün açık kalacaktır**
Başvuruya ehliyet üzerine belgelerin kopyası ve iş yerinin talep ettiği diğer belgeler eklenmelidir. Almış olduğumuz büyük sayıda taleplere göre sadece kısıtlı listeye seçilen adaylar mülakata çağrılacaktır., Kosova vatandaşlarına hizmette bulunmaktadır ve her topluluktan bayan ve erkek adayların müracaatlarını beklemektedir.

**Mamuşa** **SSRD Müdürü**
07.12.2020 Rujdi Mazrek

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Në mbështetje nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, në bazë të vendimit të këshillit drejtues të QKMF-ës Mamushe, nr.01/16 dhe në bazë të vendimit të kryetarit të komunës, nr.38-16 të datës 07.12.2020, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shpall:

**K O N K U R S**

**Titulli i postit: Mjekë të përgjithshëm (dy vend)**

**Koeficienti:** **H-565**
**Raporton:** Drejtorit Shëndetit
**Kontrata:** Nje (1) vjeçare, përfshirë periudhën provuese me mundësi vazhdimi
**Orari:** I plotë
**Kualifikimi:** Të ketë të kryer Fakultetin e Mjekësisë, të kenë të kryer stazhin e obliguar sipas ligjit dhe të jenë të licencuar.

**Titulli i postit: Infermier (dy vend)**
**Koeficienti:** **H-377**
**Raporton:** Drejtorit Shëndetit
**Kontrata:** Nje (1) vjeçare, përfshirë periudhën provuese me mundësi vazhdimi
**Orari:** I plotë
**Kualifikimi:** Të ketë të kryer Shkolla e lartë Emergjenca dhe ndhima e parë ose Shkolla e Mesme të Mjkesisë , të kenë të kryer stazhin e obliguar sipas ligjit dhe të jenë të licencuar

**Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendin e mjekit duhet t'i plotësojnë këto kushte:**
Të jenë banor të Republikës së Kosovës,
Kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes,
Kopjen e vërtetuar të Diplomës,
Licencën,
Mos të kenë fletëparaqitje penale dhe i dënuar ,
Certifikatën shëndetësore.

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve**:
Aplikacionet merren në KK e Mamushës te Shefin e Shëtsisë , të bashkangjitur me aplikacionin e gjeni edhe detyrat dhe përgjegjësit e punës për pozitën që aplikoni.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetat ditore**
Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimet dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që i kërkon vendi i punës. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara , vetëm kandidatet e zgjedhur për listën e ngushtë do të ftohen në intervistë. mirëpret aplikacionet prej femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve.

**Mamushë** **Drejtori i DSHMQS**
07.12.2020 Rujdi Mazrek

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br 03 / L-212, na osnovu odluke Upravnog odbora porodične medicine-es Mamuša, Br.01/16 a na osnovu Odluke gradonačelnika, no 38-16 od 07.12.2020 direktor Direkcije za zdravstvo i socijalnu zaštitu , objavljuje:

**K O N K U R S**

**Pozicija: Doktor opšte medicine (dva radno mesto)**
**Koeficienat:** **H-565**
**Raportira:** Direktoru zrdastva
**Ugovor:** Jenan (1) godine, obuhvata probni period sa mogučnošču produzavanja
**Radno vreme:**Puno
**Kualifikacija:** Medicinsi Fakultet, licenciran
**Pozicija: Teknčiar opšte medicine (dva radno mesto)**
**Koeficienat:** **H-377**
**Raportira:** Direktoru zrdastva
**Ugovor:** Jenan (1) godine, obuhvata probni period sa mogučnošču produzavanja
**Radno vreme:**Pšuno
**Kualifikacija:** Viša Medicinski škola za hitne slučajeve i mprve pomoci ili Srednja Medecinska škola , licenciran

**Zainteresovani kandidati mogu da konkuriwu za rukovodjenoj poziciji mora da ispuni sledece uslove:**
Da bude državljani Republike Kosovo
Kopje Licnom kartu i Rogeni izvod
Kopirajte certificiranih Diploma,
Licencom ;
Ne imati krivičnu prijavu i osuđen,
Uvjerenje o zdravstvenoj sposobnosti.

**Uzimanje i dostavlenje aplikacija**:
Aplikacije se mogu uzeti u SO Mamusa kod šefa zdrastva , zajedno sa aplikacijom mozete naci obaveze i odgovornosti radnog mesta za poziciju koju aplicirate.

**Konkurs ostaje ovoren 15 dana od dana objavlanja obavestenja u dnevnim novinama.**
Zajedno sa aplikacijom se prilozava kopja dokumenta nad kualifikacijama, i ostale zahtenve dokumente koje se zahtevaju za odredenu radnu poziciju. Zbog velikog broja primlenih zahteva, samo izabrani kandidati u uzoj listi bice pazvani na intervju. dobro docekuje aplikacije od strane zena i muskaraca shih zajednica..

**Mamusa** **Direktor DZSZ**
07.12.2020 Rujdi Mazrek

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Ministria e Infrastrukturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e pjesës "E" të autoudhës Prishtinë-Merdare (OTEJL Korridori 7).

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.12.2020 në ora 13:30 në objektin e Komunës së Podujevës, do të organizohet debat publik nga Ministria e Infrastrukturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e pjesës "E" të autoudhës Prishtinë-Merdare (OTEJL Korridori 7).

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://us05web.zoom.us/j/86012608280?pwd=eGVackExYTVJa1gzNUM3MVl3U2J5Zz09

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.







## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Gramoz Berisha shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së dhjetë të shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.

▶ "F-MAX" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810195083

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783


Kur fakti politik bëhet pjesë e historisë, e ne e vëzhgojmë atë me një distancë të ftohtë, Xhevdet Bajraj na e shpërndan atë të konvertuar në një fabul të shkëlqyer
*Cuando el hecho político pasa a formar parte de la Historia, y lo observamos con fría distancia, Xhevdet Bajraj nos lo entrega convertido en una espléndida fábula*
Héctor Carreto, poet, meksikan. - *Poeta mexicano*
Imazhet që ai evokon janë të pastra dhe të bukura, me pak njerëz, si plagë të thella e të pastra. Kur përktheja këto imazhe unë u përpoqa ta kap pafajësinë e tyre, bukurinë e tyre fëmijërore, e cila bie kaq shumë në kontrast me makthe të errëta të kujtesës së Bajrajt
*Las imágenes que evoca son limpias y hermosas, con poca gente, como heridas profundas y limpias. Al traducir estas imágenes, intenté capturar su inocencia, su belleza infantil, que contrastan de manera tan marcada con las oscuras pesadillas de la memoria de Bajraj*
Alice Whitmore, përkthyese e poezisë së Bajrajt nga gjuha spanjolle në angleze, Australi. -*Traductora de la poesía de Bajrajt del español al inglés, Australia*
Zëri që na detyron t'i modifikojmë kategoritë tona dhe referencat ndaj dhunës, tmerrit, vdekjes, braktisjes, vetmisë, e cila në këtë Amerikën tonë Latine (kaq e prirë për të shpallur dhimbje që nga heroina e romantizmit) ka qenë pretekst i poezisë pamfletuese të oportunizmit lirik
*Voz que nos obliga a modificar nuestras categorías y referencias para con la violencia, el horror, la muerte, el abandono, la soledad, que en esta nuestra Latinoamérica (tan proclive a enunciar el dolor desde la heroína del romanticismo) ha sido pretexto de panfletaias poesías de oportunismos líricos*
Carlos Pineda, poet dhe eseist meksikan. - *Poeta y ensayista mexicano*
Poezia e Xhevdet Bajrajt nxit stuhi asociacionesh te lexuesi, e shkëput atë nga realiteti trivial dhe e strehon në një realitet të ri ku mbretëron meditimi për çështje substanciale të jetës, për botën, vetminë, dhimbjen dhe rrugëtimin e njeriut në jetë
*La poesía de Xhevdet Bajraj estimula la tormenta de asociaciones en el lector, lo separa de la realidad trivial y lo cobija en una nueva realidad donde reina la meditación sobre cuestiones sustanciales de la vida, sobre el mundo, la soledad, el dolor y el viaje del hombre en la vida*
Zyrafete Shala, kritike letrare. - *Crítica literaria*
Poezi e dinjitetit mbi gërmadha. - *Poesía de dignidad sobre ruinas.*
Shqiptar Oseku, poet.- *Poeta*
ISBN 978-9951-780-09-4
6 99 €
KAFE ME NËNËN
CAFÉ CON MAMÁ
XHEVDET BAJRAJ
XHEVDET BAJRAJ
KAFE ME NËNËN poezi
CAFÉ CON MAMÁ poesía
Parathënien/*Prólogo*: Adil Olluri
ARMAGEDONI


Adem Gashi (1953), poet, prozator dhe eseist, pa lënë mënjanë njohuritë e paskajshme të tij për letërsinë shqiptare dhe për atë botërore, ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar mësues dhe ka qenë redaktor reviste, drejtor televizioni, themelues i PEN-it të Kosovës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bursist i fondacionit gjerman "Heinrich Böll-Stiftung", këshilltar i lartë politik, drejtor i Zyrës për Komunikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Është anëtar i revistës *Akademia* dhe anëtar i Këshillit Drejtues i Institutit Albanologjik. Ka botuar 24 libra dhe është nderuar me rreth 50 çmime letrare. Është prezantuar në dhjeta antologji të lirikës shqipe. Edhe pse që dy vjet ka mbushur moshën e pensionistit, krijimtarinë letrare s'ka ndërmend ta pensionojë.
Libri i katërt me tregime, me rrëfenja e me parabola i Adem Gashit, *Lakorja e fatit*, dëshmon dhe ridëshmon autorin si krijues po aq të fuqishëm edhe në prozë. Madje tani mund të vlerësohet se toka e begatë e shkrimtarit, në kuptimin cilësor të vlerave artistike dhe të hijeshisë dhe të kënaqësisë estetike, është tregimtaria.
*Lakorja e fatit* çilet me tregimin uverturë *Pëllumbi i paqes* i rimarrë nga libri me titullin omonim (*Pëllumbi i paqes*, 1989), për të lakuar strukturalisht tre kapitujt pasues: *Terr*, *Dritë dhe mjegull* dhe *Matanë*, të cilët, në aspektin e konceptimit mbarështrues të tyre, na e vizatojnë kurbën tematike dhe motivore, ideore dhe përmbajtjesore, filozofike dhe psikanalitike jo vetëm të rrëfimtarisë tregimtare, por edhe të gjenit krijues të autorit. Në këtë rast, besoj, vlen të veçohen dy aspekte: poetika moderniste me elemente të postmodernizmit dhe gërshetimi i formave dhe zhanreve letrare siç, fjala vjen, i prozës (tregimi, rrëfenjat), i poezisë (një lirikë me dy parabola poetike dhe një rrëfenjë-parabolë) si dhe i dramës, i konceptuar në trajtë të antidramës (*Maja e gishtit të madh të perandorit*).
*Dr. Emin Z. Emini*
ISBN 978-9951-780-08-7
4 99 €
ADEM GASHI
LAKORJA E FATIT
ADEM GASHI
ADEM GASHI
LAKORJA E FATIT
*(Tregime, rrëfenja dhe parabola)*
ARMAGEDONI


MËKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L